



## BASHKIA DIBËR

### RISHIKIMI I PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR

**RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE  
MJEDIS PER NENTE ZONAT NE QYTETIN E PESHKOPISE.**

**Raporti Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis**

**Hartoi: Blerina Mazari ing. Mjedisi**

## KAPITULLI II

### 5. VLERESIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS

#### 5.1. HYRJE

Shqiperia eshte nje nder vendet qe ka nenshkruar nje numer te konsiderueshem konventash nderkombetare ne aspektin social-ekonomik dhe mjedisor, si rrjedhoje zbaton nje sere rregullash te vendosura ne keto konventa te cilat kane ndikuar ne permisimet mjedisore. Disa nga keto konventa e protokolle te nenshkruara nga vendi yne jane :

- Konventa e Aarhus per akses ne informacion, pjesemarje te publikut ne vendim marrje ambientaliste
- Konventen e Rio De Janiero-s ne vitin 1996
- Konventen per vleresimin e ndikimit ne mjedis ne konteksin nderkufttar ESPOO, Finlande 1991
- Konventen mbi ndotjen atmosferike ne distance te medha Gjeneve, Zvicer 1979.

Raporti synon te jape nje informacion te detajuar dhe te besueshem lidhur me ndikimet mjedisor te projektit te propozuar ne perdonimin e tokes ,efektet mbi floren faunen , burimet e ujit etj.ndotjet akustike permisimin e infrastructures etj.nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te ceshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit.
- Shqyrtimin e alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale , nga pikepamja e ndikimit te aktivitetit mbi mjedisin human.
- Analizen e faktoreve positive e negative mjedisore ,per percaktimin e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative .
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimin cilesor te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne project.

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte I rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe I nevojshem per te gjithe qeniet ne toke . Njerezit duhet te kuptojne se si perdonimi I burimeve mjedisore dhe perfitimet qe vijnë nga ato te mos demtohen , por po te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen . Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje,toke,ajer e cila shkaton ose mund te shkaktoje problem mjedisore te perkoheshme ose te perhereshme ne balancen ekologjike te tokes .

Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdonimi I te mirave material. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara ,emetimet e gazrave te demshem ne atmosfere

,perdorimi I kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin ato mjedisit kane sjelle problem mjedisore me te cilat peballemi sot .

Ndaj eshte e nevojeshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per te mbajtur sa me paster mjedisin duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve etj. Ne menyre qe te shmangen keto problem njerezimi duhet te mesoje sit e menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrushme . Pra zhvillimi I qendrushem I burimeve natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi I tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti lene keto burime te perdoren edhe nga brezat e tjere .

Qendrushmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithe . Zhvillimi I qendrushem nuk I pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe te lene gjeneratat e ardhshme me perspektiva te uleta dhe me rreziqe me te medha se tonat . Teknologjite qe kontribojne ne zhvillimin e qendrushem perfshijne kontrollin e ndotjes ,prodhimin e energjise se riciklueshme , rikuperim burimesh dhe riciklim , menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore . Vitet e fundit industria e ndertimit ne vendin tone ka patur nje zhvillim te madh . Kompanite e ndertimit jane nder subjektet e biznisit me me teper fitim dhe me nje numer te madh te punesarish, jane dhe taksa paguesit me te medhej te arkes se shtetit.

Kemi dy tipe te impaktit mjedisor :

- Shterimi I burimeve
- Ndotja

Ne menyre qe te shmangen keto problem njerezimi duhet te mesoje se sit e menaxhoje burimet natyrore ne menyre te qendrushme .

Projektet e ndertimit te objekteve te banimit , turizmit, hotelerise te cilat kohet e fundit kane marre nje zhvillim te madh pervec zhvillimit ekonomik-social mbartin ne veteve edhe nje zhvillim te mundshem estetik te zonave ku ato ndertoehen duke marre parasysh sistemimin e hapsires, siperfaqet e gjelberta.

Objektet e kesaj hyrje – permblehdje per vleresimin mjedisor te ndertimit te objekteve ne zonat e studimit :

- Te minimizoj e streset ne mjedis dhe ne rradhe te pare ne elementet prioritare si ruajtja e tokes, kontrolli I zhurmave dhe ruajtja e cilesise se ujit dhe ajrit .
- Te ruaje ose rehabilitoje mjedisin natyror perms elementeve te reja te nderhyrjes positive , punimeve te vecanta ne kuader te projektit ose parallel me te, te cilet sigyrojne vijushmerine e qendrushme te mjedisit biologjik duke perfshire faunen dhe floren ne mjesiset perreth zones se marre ne considerate .

## **5.2. LEGJISLACIONI MJEDISOR**

Sikurse per cdo fushe tjeter legjislacioni shqiptar ne fushen e mjedisit synon te jetë ne perputhje me deriktivat dhe standartet e Bashkimit Europian. Procesi I transpozimit dhe perafshimit te legjislacionit mjedisor eshte bere me intensive qe prej nenshkrimit te MSA ne vitin 2005. Aktualisht, Qeveria Shqipetare eshte ne procesin e pershpejtimit te ketij procesi .

Megjithese ne Shqiperi ligji I pare per ceshtjet mjedisore eshte miratuar ne vitin 1967 ,pas viteve 1991 vazhdimi i kryer permisime te ligjit per problemet mjedisore . Aktualisht jane miratuar dy ligje qe rregullojn procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe lejet mjedisore qe jane :

- Ligji Nr.10431, date 09.06.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit “
- Ligji Nr.10440 , date 07.07.2011 “ Per vleresimin e ndikimit ne mjedis “
- Ligji Nr. 10448 , date 14.07.2011 “Per lejet e Mjedisit “

Projektet private apo publike , te lestuara ne shtojcat I dhe II , bashkelidhur ligjit te VKM , I nenshtrohen vleresimit te ndikimit ne mjedis, ne perputhje me kerkesat ne ligje VKM-se , per para dhenies se lejes perkatese nga autoriteti perkates per zhvillim apo jo te projektit.

### **PROCEDURA E VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PERFSHIN :**

- a) Procesin paraprak te vleresimit te ndikimit ne mjedis
- b) Procesin e thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis

Dokumenti baze , ku mbeshtetet procesi I VNM-se eshte raporti I vleresimit te ndikimit ne mjedis I cili, ne varesi te ndikimeve te mundeshme te projektit mund te jetë :

- a) Raporti paraprak I VNM-se per projektet e shtojces II
- b) Raporti I thelluar I VNM-se per projektet e shtojces I

### **Projektet qe I nenshtrohen vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis jane :**

- a) Projekte te listuarane shtojcen II , bashke lidhur ligjit te VNM ;
- b) Cdo ndryshim a shtese e listuar ne shtojcen I apo II , te licensuar paraprakisht,, qe mund te shkaktoje efekte te rendesishme negative mbi mjedisin;
- c) Projektet e listuara ne shtojcen I ,qe ndermeren ,eksluzivisht apo kryesisht ,per testimini dhe zhvillimin e metodave ose produkteve te reja , te cilat nuk jane perdorur per me shume se 2 vjet;
- d) Projektet e listuara apo jo ne shtojcen I ose II , qenukanendikimtedrejtperdrejte apo nuk jane tenevojeshme per administrimin e zoneve vecanerisht tembrojtura, por qe vecmas apo ne bashkeveprim me plane dhet projektetetjera , mundteshkaktojne efektenegative terendesishme ne keto zona . Ne keterastraporti I VNM-se perfshinedhevleresimin e ndikimevetekyereprojekteve ne kete zone, duke marreparasyshobjektivat e ruajtjes dhe

mbrojtjes se vendit ku do te zbatohen projektet..... dhe kalon ne keto faza te nje pas njeshme :

- a) Paraqitja e kerkeses dhe dokumentacionit shoqerues nga zhvilluesi ne QKL dhe percjellja e tyre nga QKL-ja ne AKM ;
- b) Dokumentacioni I kerkuar sipas ligjit nr.10 081, date 23.02.2009" Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise "
- c) Raportinparaprakte VNM-SE ,tehartuarsipasligjitteprojektit.
- d) Projektinteknikteveprimtarise.
- e) Faturen e pageses se tarifes se sherbimit .
- f) Konsultimi I AKM-se me institucionet e tjera dhe publikimi I kerkeses.
- g) Marrja e vendimit nga AKM-ja ,njoftimi I QKL-se, Ministrise se Mjedisit ,institucioneve te konsultuara, si dhe publikimi I vendimit ne Rregjistrin Kombetar te Lejeve dhe Licencave.

Pra ne perfundim te procedures paraprake te VNM-se,AKM-ja merr vendim nese nje project I shtojces II duhet ti nenshtrohet procedures se thelluar te VNM-se.

Nes AKM-ja vendos se projekti nuk duhet ti nenshtrohet procedures se thelluar te VNM-se, atehere ne vendimin e saj percakton ;

- a. Arsyet dhe konsideratat kryesore ku eshte mbeshtetur mendimi;
- b. Mendimin e institucioneve te konsultuara;
- c. Pershkrimin, sipas rastit te masave kryesore qe duhen marre per te shmangur ,reduktuar dhe nese eshte e mundur per te korigjuar ndikimet negative te mundeshme ne mjedis.

### **PROCEDURES SE THELLUAR TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS I NENSHTROHEN :**

- a. Projekte te listuara ne shtojcen I te ligjit te VNM-se
- b. Projektet, per te cilat vendimi I AKM-se parashikon nevojen e zbatimit te kesaj procedure....dhe kalon ne keto faza te nje pasnjeshme;
  - a) Njoftimin e AKM-se nga zhvilluesi per synimin e zhvillimit te projektit
  - b) Konsultimin e AKM-se me institucionet e tjera ,publikun dhe OJF-te per ceshtjet qe ato kerkojne te trajtohen ne raportin e thelluar te VNM-se
  - c) Komunikimin qe AKM-ja I ben zhvilluesit per ceshtjet qe ajo dhe palet e konsultuara kerkojne te trajtohen ne raportin e thelluar te VNM-se.

### **5.3. KUSHTET KLIMATIKE**

Rrethi I Dibres ben pjese ne zonen klimatike mesdhetare malore dhe ate mesdhetare para- malore meqenese eshte pjese e pellgjeve te lumenjve te Drinit. Ne formimin e kesaj klime kane ndikuar faktore si ; lartesia dhe reliefi I teritorit , ndikimi I madh I klimes kontinentale nepermjet ererave qe vijne nga grykat dhe qfat si rezultat dallohet per nje klime te ashper, dimer te gjate dhe reshje te medha bore por vere te fresket pa reshje . Numrimesatar I diteve me ngrica eshte 136 dite.

## **TEMPERATURAT**

Temperatura mesatare shkon nga 6 grade ne malin e Korabit ne 11 grade ne afersi te lugines. Shkaku kryesor eshte lartesia mbi nivelin e detit . Per muajin korrik temp.shkon nga 7 grade ne pjeset e larta dhe 16 grade ne lugine. Muaji janar eshte me I ftohti ku temperature shkon ne minus 3 grade.

## **LAGESHTIA**

Lageshtia e ajrit eshte e lidhur rregullisht me temperaturat e ajrit. Mesatarja vjetore e lageshtise relative ne zonen e studiuar eshte 70% .

## **E R A**

Ne Shqiperier erat qe rastisin me shume gjate gjithe vitit jane te kuadrantit te veriut dhe pas ty reatote jugut. Era ne keto zona fryn e lehte gjate veres dhe e forte ne dimer. Shpejtesia mesatare e eres varion nga 1.6m/sek(qershori) dhe 3.4m/sek (shkurt) dhe mes.vjetore arrin ne 2.5 m/sek.

## **RRESHJET**

Persa I perket sasise se reshjeve zona futet ne zonat nen mesataren e vendit. Kjo vlore shkon ne 900 mm shi dhe lidhet me deportimin e ererave te ftohta e te thata. Pjesa me e madhe e tyre eshte perqendruar ne muajet e ftohte. Maximumi I reshjeve ne 24 ore ka qene 127 mm. Per reshjet e debores mund te themi se ato fillojne ne nentor dhe mbarojne ne mars dhe numri mes. I diteve me bore shkon ne 38 ditedhekrijonnjeshtresemesprej 30-35 cm.

### **5.4. GJEOLOGJIA, GJEOMORFOLOGJIA**

Shqiperiasiformaciongjeologjikeshtepjeseperberese e rrudhosjesalpino-mesdhetare, pjese e degezimitDinaro-albano-helenid, kubejmepjesetekAlbanidet.

Ndertimi gjeologjik I Dibres mundeson zhvillimin pasi kjo zone eshte e pasur me minerale, lende ndertimi etj. Ky ndertim gjeologjik ka bere qe vendbanimet te vendosen kryesisht ne perberiet gelqerore dhe ne kontakte te tjera per arsyte te burimeve hidrike .

## **NDERTIMI GJEOLOGJIK DHE HIDROGJEOLOGJIK**

### **Studimet ekzistuese**

**Zonat e marra ne shqyrtim :**

- AR 8.4.2
- AR 8.4.17 /A3.3.16
- AR 8.4.1
- AS .1.99

- A.3.1.30 / A3.1.930 /A3.1.261 /AS.1.99

- **NDERTIMI GJEOLLOGJIK I ZONES.**

Ne zonat ku eshte pozicionuara studimi kemi nje larmi formacionesh gjeologjike, ku ne nje zone teper te afert kemi nje nderthurje te moshes gjeologjike sic jane formimet e permo-triasikut te poshtem , formime karbonatike te moshes paleozoiske te cilat jane ne krahun veri -lindor te pozicionit te vend ndertimit sidomos ne zonen e Llixhave .Jane formime me uje pershkueshemri te larte dhe shume te larte .Kane fortesi 3. Dhe kane ngjyre te bardhe ne gri, formime te cilat per nevoja industriale mund te perdoren ne prodhimin e allcise.

- **KEMI TE BEJME ME KETO FORMACIONE GJEOLLOGJIKE.**

1.Pg2-2--→formime te Paleogenit te Mesem , formime konglomeratike te cimentuara, pak te cimentuara dhe te cimentuara mire, formime me qendrueshmeri mesatare deri te larte me ujepershkueshemri te vogel dhe shume te vogel.

Ne keto formime del edhe burimi i Llixhave ne formen enje pusi artezian nga thelesia 1180 m nen nivel te detit, ndersa ne siperfaqe del ne lartesine 718 m dhe ka prurje ne burimin 1 sasine prej 8.501 uje /sec dhe ne Burimin 2 sasine prej 1 1 uje /sec. Burimet 1 dhe 2 jane prane njeri tjetrit prej nje distance prej 20 m.

2.P-T1→formime te Permo Triasikut Te Poshtem, , formime karbonatike te moshes paleozoiske te cilat jane ne krahun veri- lindor te pozicionit te vendndertimit te zonave .Jane formime me uje pershkueshemri te larte dhe shume te larte .Kane fortesi 3. Dhe kane ngjyre te bardhe ne gri, formime te cilatper nevoja industriale mund te perdoren ne prodhimin e allcise.

- **KUSHTET HIDRO -GJEOLLOGJIKE.**

\*Ne anen perendimore ku dalin burimet 1 dhe 2 te llixhave , rrerh 30 m larg vend burimeve kemi perroin e Llixhave dhe rrerh 700 m larg tyre ne anen veri perendimore kemi perroine Zagradit.

\*Perroi i Llixhave eshte nje perrua malor me prurje te ndryshueshme ne varesi te reshjeve atmosferike dhe shpesh here eshte i rembyeshem por pa deme ne objektet e ndertuara rrerh tij pasi jane marre masa mbrojtese nga ana e vete qytetareve.

\*Ndersa perroi i Zagradit nga vet largesia qe ka nga burimet nuk ka ndikim fare .

\*Burimet hidrike 1 dhe 2 pra burimet termale dalin nga thelesia ne formen e nje pusi artezian i cili ka prurje te njetrajtshme gjate gjithe kohes se daljes ne siperfaqe qe nga krijimi i tyre i cili i perket moshes paleogenike. Thlesia e daljes se burimeve ne siperfaqe nga niveli i detit eshte 1180 m. Si rezultat i formimeve nga ku burojne ujerat termal meq Jane formime me uje

pershkueshmeri fare te vogel nuk kane ndikim ne burimet qe dalin ne siperfaqe.Ne siperfaqe keto dy burime dalin ne lartesine 718 m .

\* Po ashtu edhe prurjet e ketyre dy perrenjve , si ai i llixhave ashtu edhe i Zagradit jo vetem nga distanca por edhe nga formimet nga te cilat dalin burimet nuk kane ndikim ne perzierjen me ujin termal pasi paretet e pusit artezian jane te emaluaara nga formacioni permotriasic i cili nuk lejon perzierjen e ujerave siperfaqesore dhe nentokesore ne te.

\*Ne kushtet hidro-gjeologjike te territorit te bashkise kemi keto burime

1.Lumi Drini i Zi i cili ne territorin ebashkise Diber futet tek ura e topojanit deri tek ura e dodes ne Rec. Eshte nje lume me prurje te ndryshueshme ne varesi te rreshjeve atmosferike dhe shpeshhere behet i permbytshem per zonat fushore prane tij.Perberja e shtratit te lumbit eshte kryesisht granulometrike.ranorike etj.

2.Kemi perrenje malore qe rrjedhin ne te dyja anete shtratit te lumbit.ne krahun lindor rrjedhin 1. perroi i Pesjakes, 2 .perroi i Herbelit ,3. perroi i Dovolanit,

4. perroi i Melanit, 5. proska e Greves ,6. perroi i Begjunecit ,7. perroi i Llixhave ,8. perroi i Zagradit,

9. perroi i Tominit, 10 .perroi i Deshatit, 11. perroi i Kaut, 12. perroi i Veleshices, ndersane krahun perendimor kemi perroin eGurres ne Luzni, perroin e Murres , lumin e Setes , perroi i Gurit te Plakes, perroi i Lugut te thelle , perroi i Kubellit, perroi i Lashkizes etj.

Karakteristikat ektyre perrenjve jane perrenj malor me prurje te ndryshueshme ne varesi te stines. Shpeshhere behen te rrembyeshem si shkak i prurjeve te ndryshueshme. Ne disa prej tyre ka patur nderhyrje per rehabilitim me mure mbrojttes dhe prita malore per te zbutur efektet negative ne truallin rreth tij.Kemi te bajme me nje klime mesdhetare kontinentale .me shperndarje reshjesha vjetore 980 deri 1100 mm shi ,bore dhe rralle bresher .Keto rreshje sherbejne per burime ujore te qytetit te Peshkopise dhe fshatrave perreth per pirje ku mund te vecojme disa prej tyre:

Gurra e Dipjakes me prurje 32.7 l uje ne sekonde.

Gurra e Merajve Luzni 8 l uje ne sekonde .

Ne Llixha 80-100 l uje ne sekonde .

Burimi i Rumelice Maqellare 6 l/uje ne sekonde .

Burimi I Izvirit 450 l/uje ne sekonde .

Kroi i Abazit 25 l/uje ne sekonde.

Burimi I Sopanikes qe furnizon me uje nje pjese te banoreve te Peshkopise kryesisht fshaterate fushes.

Burimi i Xhaxhajt , buron ne pjesen prendimore te lumbit Drin , ne zonen e Lures. Edhe ky burim eshte i shfrytezueshem nga zonat perreth.

Keto burime shfrytezohen nga banoret perreth si dhe nga banoret e qytetit te Peshkopise per nevoja familjare.

Ndersa burimet e perrenjve malore dhe te lumbit Drin sherbejne per vadirje te bimeve bujqesore.Sasia e madhe e reshjeve vjetore ben qe resurset ujore ne territorin e bashkise te jen ete konsiderueshme pasi nentoka ruan rezerva ujore qe shfrytezohen ne vijimesi.

#### **Zonat e marra ne shqyrtim :**

- SH .3.13
- AS .1.8
- A3.1.20
- A3.2.7

ne nje teren te sheshte pa pjerresi (pjerresi shume e vogel ne drejtimin perendim-lindje). Gjeologjia e shtreses se zones se studiuar paraqitet si me poshte :

1. **Qp-h** -- Depozitime eluviale, deluviale dhe koluviale etj. Paraqiten me ndertimheterogen me perberje argjillore
2. **N2-Qp** – Depozitimeliqenorelumore me material tetrshetecimentuardobet me dhe pa rrumbullaksime.
3. **Pg2** - -Perfaqsohet nga rrreshjet argiloreranorike dhe ndershtrese zalinzakarbonateshdherallemergelesh.
4. **J3-Cr2** --- Shisteargjilorekarbonatike, mergelere, silicoreetj.
5. **T1-2** --- Seria efuzive sedimentare perfaqsohet nga formimet e series efuzive-sedimentare te perberjes ,shiste,argjilore,silicore etj.

#### **KUSHTET HIDRO-GJEOLLOGJIKE**

Rethi I Dibres ka nje rrjet hidrografik shume te pasur qe perbehet nga lumenj, lijenj, perrenj, burimetokesoredhenentokesore. Deget e perrenjve qe merr Drini I zi si Murra, Seta etj. Kane karaktertevrullshem me prurjetemedhegjateshkirjes se bores.

Nga studimet e kryera ne zonen e fshatit Maqellare ku do te behet ndertimi,nder vite rezulton se niveli I ujrate nentokesore ne vere dhe dimer eshte I ndryshem. Nga studimet eshte nxjerre se niveli I ujrate eshte ne nivelin e 20 m nen siperfaqen e tokes, por ka raste qe eshte me larg ne periudhen e thatesires. Kjo tregon se gjate hapjes se gropave per themele e plinta uji qe mund te jete mund te largohet lethesiht pa penguar ndertimin. Vendi ku do ndertohet godina ka nje podrum nen toke dhe per keto kushte nuk kemi asnje problem .

## **5.5. SIZMICITETI**

Trualli shqipetar vendoset gjate kufirit te perplasjes se dy pllakave te medha qe levizin njera kunder tjetres; places Euroaziatike dhe asaj Arabo-afrikane, dhe eshte vater e perqendruar te rmetesh e cila preket me shpesh nga termete demtues. Ne teritorin tone me probabilitet rreth 80% mund te ndodhe termet 7 balle cdo 5 vjet dhe 8 balle cdo 10 vjet dhe termet 9 balle cdo 30-40 vjet .

### **AKTIVITETI SIZMIK I Qytetit Peshkopi, Bashkia Diber**

Peshkopia ben pjesë ne zonen Elbasan-Diber-Tetove me max= 6.9, eshte ze prekur nga termetet me magnitude 5.5-6.9 gradeRihter dhe me intesitet 7 balle mund te shkaktoje deme te medha.

## **5.6. EKOSISTEMET, FLORA, FAUNA**

Pozita gjeografike e qytetit Peshkopi , kushtet natyrore te saj, ndertimi gjeologjik, copetimi I madh I reliefit te tij ka ne kushte shume llojshmeri te madhe bimesie europiane dhe ne very ballkanike, ku keto perfaqsohen nga ; shkurre mesdhetare, dushqe,ahu, pisha etj.

Ndersa zona ku percaktohet ndertimit te objekteve te Peshkopise ka nje peisazh te zakonshem urban dhe nuk gezon nje status te vecante si zone e mbrojtur. Flora e fauna jane tipike te nje zone te banuar.

## **HIDROGJEOLOGJIA**

Ne zonen ku do hapen shesh ndertimiet verehen se nuk ka burime siperfaqsore dhe perreth saj nuk ka zone te lundrushme (lumenj, perrenjetj) pra nuk do cenohen rruget ujore, brigje etj.

## **5.7. CILESIA E AJRIT DHE ZHURMAT**

Emitimet me te medha te pluhurave mund te ndodhin gjate punes ndertimore por, pluhuri nuk shkakton ndryshime afatgjata ne cilesine e ajrit lokal, por depozitimi I tyre ne maledjet ne afersi shkaton ndotje por keto jane te perkoheshme dhe kalimtare . Madhesia e grimcave PM10 eshte relativisht e vogel , afatshkurter dhe me efekte te parendesishme . Nuk parashikohet qe keto grimca te ndikojne ne shendetin apo ndotje te efekteshme te ajrit ne zonen ku ndertohe . Pra do kete nje cilesi te ajrit nene vlerat kritike te normave te Shqiperise .Zhurmat nga aktivitetet e ndertimit mund te jene te rendesishme per nje periudhe te shkurter kohe. Nivelet e zhurmave gjate ndertimit mund te ndryshoj ne gjate fazave te ndryshme te proceseve te punes . Por kjo mund qe te menaxhohet mire gjate procesit te ndertimit per te realizuar normat e tyre si pas standarteve europiane .

Per kete investitori do te marre te gjitha masat sipas ligjit nr.7994,dt.12.07.2007 nepermjet :

- a. Per zgjedjen e mjeteve dhe pajisjeve qe do perdoren (me zhurme te uleta)
- b. Masat parandaluese, zbutese te zhurmese, duke punuar ne kohe te pershatshme te dites etj.
- c. Ndikimet e zhurmave te vibrimit, transportit jane te vogla duke u menaxhuar mire ato qe thame me siper .

## **5.8. TRASHEGIMIA ARKITEKTONEKE , ARKEOLOGJIKE DHE HISTORIKE**

Ushtrimi I aktivitetit te ndertimit nuk prek zonat turistike se ndodhet ne distance te largeta nga objekti ne studim . Ne zonen e kerkuar per ndertim nuk ka objekte arkeologjike , kulturore dhe me interesa historike perreth.

### **STATUSI I ZONES**

Teritoret ne studim nuk jane te perfshire as ne menyre te drejt perdrejte, as ne menyre indirekte ne zone te mbrojtur si :

- a) Rezerve strikte natyrore
- b) Park kombetar
- c) Monument natyror
- d) Rezervat natyror I menaxhuar
- e) Peisazh I mbrojtur
- f) Zone e mbrojtur me perdomim te shumefishte

Zonat ne studim nuk ben pjesa ne zonat e mbrojtura me interes nderkombetar etj.

## **5.9. TOKA DHE PERDORIMI I SAJ**

Teritori ku do implementohet projektet si zonat :

- A3.1.20 ,(Rasti 1)
- A3.1.30,
- A3.1.930,
- A3.1.261,
- AS.1.99,
- A3 3.2.7(Rasti 4)
- AS 1.8 (Rasti 6)
- AR 8.4.1(Rasti 7)
- AR8.4.17
- A3.3.16
- SH 3.13

jane pa vegjetacion dhe nuk perben vlera si toke bujqesore. (Objektet qe do te ndertohen ndodhen Brenda planit rregullues te qytetit te Peshkopise.

Ne tabelen e meposhteme jane permblehdhur vleresimet per gjithesuese per pronat dhe elementet e saj :

*Tabela : Vlerat mjedisore dhe bujqesore*

Vlerat ekonomike	Vlera ekologjike	Potenciale Rikrijues edhe turistike	Vlera edukative	Vlera nderkufitare
<b>Te konsiderueshme</b>	<b>Nuk ka</b>	<b>Ka</b>	<b>Ka</b>	<b>Nuk ka</b>

## ALTERNATIVA PA ZHVILLIMIN E PROJEKTIT

Ne mjediset ku do operojme me projekte do te kemi nje ndikim ne mjedis pasi do te kete sistemime me peme (regullueshmeri te lokacioneve perrethe objekteve), do te perdoren fasada cilesore dhe te pershtatura me arkitekturen zonale ,dhe do krijohet nje kompleks ndertimesh shumefunksionale ne keta zona .Pra duke marre ne kosiderate edhe efektet negative e ato positive arrijme ne konkluzionin se realizimi I ketij projekti do te ndikoje ndjeshem ne permisimin e jetes se banoreve , ne sistemimin e mjedisit, ne sistemimin e fasades kryesore ne rruget auto qe jane shume te shfeytezueshme dhe po permendim nje prej tyre ,si ajo e unazes se vogel te qytetit te Peshkopise.

### NDIKIMI NE UJRAT SIPERFAQESORE

Nga veprimitaria e punimeve, si germimet transporti I dherave etj. Eshte e kuptueshme qe do kete pluhura . Megjithate meqenese zonat nuk kan rrjedhje te perhereshme ndikimi do jete I kufizuar.

### NDIKIMI NE UJRAT NENTOKESORE

Persa I perkет ndotjes nga ujrat nentokesore mund te permendim te njejtat argument si ne ato siperfaqsore. Nuk do kemi premise per ndotje nga keto ujra sepse nuk do kemi perdonim te lendeve helmuese apo ndotese.

### **2.10. Identifikimi i ndikimeve te mundeshme negative ne mjedis te projekteve , perfshire ndikimet ne biodiversitet ,uje, toke dhe ajer.Masat qe do te merren per zbutjen e ketyre ndikimeve**

#### **Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne ajer.**

Ne zbatimin e ketij projekti per ndertimin e ndertesave 7 kate (5 kate Banimi + 2 kat sherbime dhe nje kate nen toke ,per shfrytezim parkingjesh) nuk do te kete ndonje ndikim te madh ne mjedisin ne teresi dhe kryesisht ne ajer. Kryerja e punimeve ne keta projekte nuk shoqerohen me emetime kimike, per rrjedhoje nuk kemi te bajme me perqendrime dhe

ndikim te tyre ne mjedis. Disa nga ndikimet e mundeshme ne ajer por qe jane minimale, mund te theksojme:

- Ndertimi i rrugeve dhe infrastruktura ne ndertim
- Shkarkim i sasive minimale te gazeve nga automjetet dhe makinerite qe punojne me karburant.
- Krijimi I sasive te pluhurit sipasoje e qarkullimit te makinave gjate Transportit te materialeve te ndryshme.

Gjate procesit te punes pluhurat mund te konsiderohen si problem gjate stines se thate te veres e kurfryjne ererat e thata te cilat ndikojne ne ngritjen e pluhurit, gjithashtu pluhurat jane si mundesi edhe gjate shkarkimit dhe manipulimit te materialeve. Por kjo eshte e perkoheshme.

Gjate stineve me lageshti keto pluhra nuk perbejne shqetesim pasi jane ne sasira te vogla.

#### **Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne ajer.**

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasojat ne mjedis
1	Shkarkim i sasive minimale te gazeve nga automjetet dhe makinerite qe punojne me karburant.	Ndotje e ajrit. Sasia e gazeve NO <sub>x</sub> dheSO <sub>x</sub> qe do te shkarkoheteshstandard i teknologjise se automjetet e makinave qe do te perdoren gjate punimeve te parashikuara.
2	Emitim zhurmashnga automjetet dhet mjetet e punes.	Ndotje akustike. Objekti eshte i distancuar nga qendrat e banuara, keshtu qerritja e nivelit te zhurmavenuk do te krijoje probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsej operacionet e punes do te jene te limituara ne kohe.
3	Krijimi i sasive te pluhurit si pasoje e qarkullimit te kamioneve qe jetat transportit mbetjeve inerte.	Ndotje ajri. Ky fenomen do te jete me i dukshem gjatesi se thate, ne sasi te limituara per shkak te volumit te punimeve qe do te shqetesoje kryeshtfaunen ne zone, pasiqendrat e banuar ja nelarghe bimesia e rralle.

## **Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne ujrat siperfaquesore dhe nentokesore**

Zbatimi i ketyre projekteve per ndertimin e nderteses 7 kate ( 5 kate Banim +2 kat sherbime), nuk do te kete ndonje ndikim ne ujrat siperfaquesore e nentokesore. Ne ket siperfaqe toke, te miratuar, nuk ka dhe nuk kalojne ujra te cilat mund te ndikohen si rezultat i zbatimit te ketij projekti. Keto mbeturina do te depozitohen larg qytetit ne nje vend te miratuar nga pushteti vendor.

### **Ndikimi ne biodiversitet.**

Teritori i Bashkise se Peshkopise vleresohet si shume e pasur per biodiversitetin, duke e futur ate nder zonat me interesante te Shqiperise.

Kjo pasuri e madhe dhe e shendetshme eshte nje rezultat i veprimit gjate gjithe historise te faktoreve biotik dhe abiotik duke perfshire relievin, gjeomorfologjine, token, vegjetacionin, faunen, floren, kushtet e klimes.

#### ***Zonat me bimesi me te lart se 6 rastet e tjera:***

- AR.8.4.7
- AR.8.4.1
- AR.8.4.2

kan bimesi te paket por shume te larmishme ku midis tyre dallohen ekosistemet pyjore te shkurreve , te dushqeve, te pemetarise frutore, te kullotave alpine , si edhe ajo e siperfaqeve te degraduara.

Te gjitha keto ekositeme kane vlera te veçanta sidomos ne sektore te caktuar me vlera shkencore dhe turistike.

Shumellojshmeria e flores duke filluar nga shkurret mesdhetare e deri tek kullotat alpine ben te mundur nje pasuri per shfrytezim per qellime te ndryshme si ajo blektoriale , industria e perpunimit te drurit , turizmi etj.

Peshkopia është një qytet i gjelbër me rreth 1,700 drurë dekorativë të kultivuar në hapësirat e gjelbërtë të qytetit. Kryesisht, pishë e zezë, bredh, cedër, liguster, bli, gështenjë e egër, shelg lotues, panjë fletëfrashër dhe mali, mështekën, gledicie etj. Sipërfaqja e pyjeve është afersisht 16,6 ha dhe shpyllëzimi i shkaktuar nga prerja e pyjeve mbetet problematik

Zonat e shfrytezimit per ndertim te objekteve jane ne pergjithesi zona te zhveshur me kullote pak te zhvilluar. Larmia biologjike e zonave paraqitet e varfer dhe perqendrohet kryesisht ne shkurre te rralla dhe disa gjitareve te vegjel e shpend te zakonshem.

Ne siperfaqen e tokes ku do te grumbullohen mbetjet inerte nuk ka pyje dhe drure te larte. Po ashtu edhe fauna karakteristike e zones eshte e paprekshme nga efektet e shfrytezimit, per aresye se aktiviteti nuk e demton ate ne lloje e numer.

Mungon plotesishte bimesia drunore e larte. Kjo zone eshte e mbjelle me drufrutore te llojit kumbull e zeze tropojane , molle, etj .

Ne teritoret ku do te ndertohen objekte nuk ka bime endemike, te kercenuara e te rrezikuara apo specie bimore te mbrojtura nga Konventat ku bene pjese vendi yne.

Per te ardhmen, per Bashkine Peshkopi, si nje nder objektivat kryesor eshte edhe sigurimi i qendrueshemerise se ketij biodiversiteti dhe ruajtja e specieve te rrezikuara te flores dhe faunes.

#### **Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne biodiversitet.**

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasopjat ne mjedis
1	Nderhyrje ne habitatet ne zona.	Demtim i habitateve. Siperfaqja ku do te ndertohet ndertesat 7 kate (5 katebanim + 2 kat sherbim) nuk jane toka produktive te cila nuk ndikojn ne proceset ekologjike. Disa procese qe lidhen me shume me shqetesimet dhe cilesine e mjedisit , do te ushtrojne ndikimet e tyre ne boten e gjalle si do mos, do te mbajne larg zones disa lloje shtazore.

#### **Identifikimi i ndikimeve te mundeshme negative ne peisazh.**

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasojat ne mjedis
1	Ndikime ne peisazh dhe topografine e terreni ku ndodhet objekti.	Ndertimi i ndertesave 7 kate (5 katebanim + 2 kat sherbim), ne kete siperfaqe toke,nuk do te ndikoje negativisht ne peisazhin e kesaj zone.

- **Ndikime ne siperfaqen e tokes gjate ndertimit e zbatimit te projekteve . Masat per mbrojtjen e tokes nga ndotja dhe demtimi fizik.**

Duke u nisur nga lloji i ketij aktiviteti dhe vendi ku ai zhvillohet, tregon se nga ushtrimi i ketij lloj aktiviteti nuk ka demtim fizik te tokes dhe mjedisit te jashtem. Te gjitha mbeturinat qe dalin si rezultat i procesit te punimeve te ndertimeve te ndryshme te kryera ne keta objekte, do te grumbullohen dhe do te depozitohen ne nje siperfaqe toke te pershtateshme, te paracaktuar e miratuar nga Keshilli Bashkiak Peshkopi. Siperfaqja e tokes ku do te zbatohen projektet nuk jane toka produktive dhe pse disa prej tyre si:

- AR.8.4.7
- AR.8.4.1
- AR.8.4.2

bejn pjes ne kategorin “**N.Toke Natyrore**”,

- A3.1.20
- A3.1.30 / A3.1.930 / A3.1.261 / AS.1.99
- A3.2.7
- A3.3.16

bejn pjes ne kategorin “**UB-Banim** ”,

- SH.3.13

bejn pjes ne kategorin “**SH- Shendetesi**”,

- AS 1.99
- AS 1.8

bejn pjes ne kategorin “**Arsim**”,

Gjate ushtrimit te aktivitetit eshtë parashikuar mbrojtja ne menyre sistematike e sipërfaqeve natyrale te tokes nepermjet masave per rehabilitimin e siperfaqes se shfrytezimit te parashikuar ne projekte .

Gjate dhe pas shfrytezimit nuk do te kete ndryshime ne topografine lokale. Ne kete project eshtë parashikuar nje rradhe dhe drejtim itille I punes, qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes , sistemi mit dhe trajtimit , parandalojne erozionin , shembjen dhe vithisjen e sipërfaqes se tokes perreth saj.

Ne sipërfaqe do te jete vetem grumbullimi I përkohshëm I mbeturinave inerte ne sheshin ekzistues dhe transportiimet e jshtme do te behet me kamione per ne destinacion.

- **Erozioni gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit**

Territori ku do te ndertohen objektet:

### 7 kat ( 5 kate Banim + 2 kat Sherbime) ne zonat:

- A3.1.20,
- AR.8.4.2,
- A3.2.7
- SH .3.13

### 6kat ( 4 kate Banim + 2 kat Sherbime) ne zonat:

- A3.1.30 / A3.1.930 / A3.1.261 / AS.1.99
- AR.8.4.17

### 4kat ( 2 kate Banim + 2 kat Sherbime) ne zonat:

- AR.8.4.1

### 3 kat ne zonat:

- AS.1.99,

nuk paraqet problem te erozionit. Megjithate shpatet e siperfaqes se tokes se shfrytezuar do te ruaje pjerresine prej 45% dhe njekohesisht veshja me argjile dhe ngjeshja me rrul do te ul efekteterozive. Nga ana e punonjesve qe do te meren me menaxhimin e aktivitetit do te tregohet kujdes I vazhdueshem per ta mbajtur nenkontroll dhe shmangur kete fenomen. Ne projekte, parashikimi I kanalit per pritjen e ujrale eshte nje mase parandaluese edhe per erozionin, shembjen dhe vidhisjen e shpateve te gropes dhe siperfaqes se tokes rrrehsaj.

### **Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne toke.**

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasojat ne mjedis
1	Shqetesim i shtrese se tokes per shkak te hapjes se rruges se re, punimit te hapjes.	Sasi te vogla dhe u gjenerohen. Kjo sasi dhe umund te sistemohet per gjate hapjes se rruges dhe te perdoret ne fazen e fundit per qellime rehabilitimi dhe mbushjeje.
2	Levizja e mjeteve te punes dhe automjeteve te transportit mbi siperfaqen e tokes.	Ngjeshja e tokesngalevizja e automjeteve dhe mjeteve e gjate punimeve te rikonstruksionit dhe atyre te reja do te limitohen brenda siperfaqes se kerkuar.
3	Erozion minimal ne kohe me rreshje ne siperfaqen ku do te depozitohen	Largimi i grimcave te tokes qe ekspozohen ndaj agjenteve atmosferike

	ketombeturina inerte.	duke u shkeputur dhe levizur kryesisht drejt trupave ujore si perrenj dhe proskat ne afersi te objektit.
4	Avaritekniqe, derdhje e karburanteve dhe lubrifikanteve.	Ndotje e tokes si pasoje e rrjedhjeve te karburanteve e lubrifikanteve , por per shkak te vellimit jo te madhe te punimeve dhe numrit te reduktuar te makinerive, ndotja do te jete ne sasi te vogla.

### Identifikimi i ndikimeve te mundeshme nga mbetjet e ngurta.

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasojat me mjedis
1	Gjenerim i mbetjeve te ngurta nga aktiviteti njerezor.	Ndotje urbane. Dhera, copeza tullash,betone, rere,zhavoretj.

### Ndikimet nga zhurma dhe vibrationet.

Persa i perket niveleve te zhurmave nga zbatimi i projektit verejme se gjate operacioneve te ndryshme te punes siç eshte transporti dhe gjate shkarkimeve te materialeve inerte, kemi te bezme me nivele zhurmash qe nuk i kalojne normat e lejuara.

Njekohesisht, duhet theksuar se keto zhurma nuk ndikojne ne jeten normale te banoreve te kesaj zone.

### 2.11. Mundesite e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesite e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme dhe kostot financiare.

### Mbyllja dhe rehabilitimi i siperfaqes se vendburimit.

Duke pasur parasysh qe projekti i ndertimit te ndertes 7 kat (5 katebanim + 2 kat Sherbime), nuk eshte i perkoheshem, ne perfundim te kohes se shfrytezimit te kesaj siperfaqe toke, eshte e nevojshme te merren disa masa rehabilituese qe parandalojne ndikimet mjedisore ne kete zone. Per kete qellim eshte i nevojshem hartimi i planit te rehabilitimit mjedisor i cili duhet te trajtoje keto çeshtje kryesore:

- Teknike, per hapjen e kanaleve te disiplinimit te ujrale nentokesore e siperfaqesore, demolimin dhe largimin e ndertimeve siperfaqesore.
- Mjedisore, duke filluar nga rehabilitimi i siperfaqeve te demtuara e te xhveshura nga aktiviteti i kryer, deri ne realizimin e mbjelljeve me bimesi autoktone te siperfaqeve te demtuara nga aktiviteti.

Rehabilitimi i mjedisit te ndikuar nga ndertimin i stalles eshte percaktuar ne kuadrin ligjor Shqiptar, si dhe aktet nenligjore qe kane dale ne zbatim ligjeve kryesore te mjedisit.

- Ligji nr. 10431 date 09.06.2011 “ Per mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji nr. 10440 date 07.07.2011 “ Per Vleresimin e Ndikimit ne mjedis Mjedis”
- Ligji nr. 10463 date 22.09.2011 “ Per Menaxhimin e IntegruarteMbetjeve”
- Ligji nr. 10448 date 14.07.2011 “ Per Lejet e Mjedisit”

Aty percaktohet qe subjektet te cilat ushtrojne aktivitetin e tyre duke pasur impakte ndaj mjedisit, jane te detyruara te rehabilitojne mjedisin gjate ushtrimit te veprimtaris edhe ne fund te saj.

Gjithashtu percaktohen dhe proceset rehabilituese te shoqeruara me kostot financiare. Konkretisht, investitori (Privati, qe do te ndertoj, do te zbatoje planin e rehabilitimit te siperfaqes se tokes ku do te ushtroje aktivitetin e sherbimeve.

Plani I rehabilitimit ka per qellim kthimin e mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e me parshm edhe do te perqendrohet ne keto pika :

- Heqjen e te gjitha paisjeve e makinerive nga siperfaqja e tokes.
- Sistemimin e shesheve te depozitimit te mbeturinave inerte.
- Mbjelljen e bimesise.
- Kujdesi per bimesine e mbjelle.

Te gjitha keto procese perbejne planin e rehabilitimit dhe shoqerohet me koston financiare sipas planifikimit .

## **2.12. Masat e mundshme per shhangien dhe zbutjen e ndikimeve ne mjesit.**

Ne zbatimin e ketyre projekteve , do te mbahen ne konsiderate mbrojtja e mjedisit dhe standartet mjedisore si dhe te aplikohen masa konkrete. Çdo zbatim i projektit duhet te

shoqerohet me planin e masave per mbrojtjen e mjedisit dhe shhangjen e demeve mjedisore te pariparueshme.

Masat per mbrojtjen e mjedisit do te planifikohen dhe zbatohen gjate operacioneve me ndikim ne mjeidis si ne fazen pergatitore ashtu edhe ate te shfrytezimit te kesaj siperfaqe toke. Ne kete seksion do te trajtohen masat kryesore per mbrojtjen e mjedisit dhe zbutjen e ndikimeve negative te identikuara ne seksionin para ardhesh. Masat e propozuara lidhen me fazat dhe aktivitetet e meposhteme :

**Masat per zbutjen e ndikimeve gjate fazes pergatitore sipas receptoreve te mjedisit.**

Nr.	Lloji I ndikimit	Masat e propozuara
1	Shqetesim I shtreses se tokes per shkak te ndertimit te rruges.	Sasia e dheut mund te sistemohet per gjate rruges dhe te perdoret per qellime rehabilitimi ne faza te ndryshme te shfrytezimit ose per rehabilitimin e rrugeve dhe siperfaqeve te demtuara ne perfundim te projektit
2	Ngjeshje e pjeseshme e tokes nga levizja e automjeteve te transportit si kamione, etj.	Per parkimin e makinerive dhe automjeteve dhe kryerjen e sherbimeve te mirembajtjes do te shfrytezohen vendet e caktuara.
3	Erozion siperfaqesor ne mot me rreshje.	Do te hapen kanalet e drenazhimit ne siperfaqe. Pergjate segmenteve te rruges ne varesi te terrenit dhe kushteve te tokes do te hapen kanale anesore qe do te ndalin forcen gerryese te ujrate te rreshjeve, ndersa pergjate perimetrit te sheshit te depozitimit te mbetjeve inerte do te hapen kanale perimetrike kufizuese qe do te frenojne gerryerjen dhe transportin e tokes. Ne pjese te vecanta do te shihet mundesia e mbjelljeve te fidaneve pyjore te pershtatshem per zonen fitoklimatike.
4	Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes.	Makinerite e transportit do te kontrollohen per vazhdimesht per gjendjen teknike te tyre dhe do te riparohen per difektet e shfaqura

### **Masat per mbrojtjen e ajrit.**

<b>Nr.</b>	<b>Lloji I ndikimit</b>	<b>Masat e propozuara</b>
1	Emetimet e pluhurit , zhurmës, gazeve, aromave dhe vibracioneve.	Makinerite duhet te mirembahen teknikisht qe zhurma e tyre te jetë vetem teknologjike dhe jo e avarive. Ato duhet te perdoren me eficence dhe te minimizohet koha gjate se ciles mbahen ndezur motoret. Skapamentot duhet te kene ne gjendje funksionale filtrat e tyre teknologjike te kapjes se grimcave.

### **Masat per mbrojtjen e peisazhit.**

<b>Nr.</b>	<b>Lloji I ndikimit</b>	<b>Masat e propozuara</b>
1	Ndikime ne peisazh dhe topografine e relievit.	Ndertimi i ndertesës 7 kate (5 katebanim + 2 kat Sherbime) ne kete siperfaqe nuk demtqjne siperfaqen e relievit. Keto siperfaqe do te rehabilitohen menjehere sa po te mbaroje ndertimi i objektit.

### **Masat per mbrojtjen e biodiversitetit.**

<b>Nr.</b>	<b>Lloji I ndikimit</b>	<b>Masat e propozuara</b>
1	Ndikime ne faune.	Shoferet do te udhezohen te bejne kujdes gjate transportit ne zona pyjore per te mos shtypur kafshe qe mund te jene ne mes te rruges. Ato duhet te kalojne ne rruge te lira.

### **Masat per administrimin e mbetjeve urbane.**

<b>Nr.</b>	<b>Lloji I ndikimit</b>	<b>Masat e propozuara</b>
1	Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njerezor.	Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetesor i punetoreve apo ambalazhet do te grumbullohen ne vende te posaçme. Ato do te transportohen drejt qendrave me te aferta te banuara per menaxhim nga sektoret perkates te pushtetit lokal. Gomat dhe vaji lubrifikant I perdonur do tujepen subjekteve qe merren me

		riciklimin e tyre dhe qe aktualisht operojne ne shqiperi.
--	--	---

## **Masat per zbutjen e ndikimeve gjate fazes se shfrytezimit te objektit**

### **Masat per mbrojtjen e tokes nga ndotja dhe demtimi fizik.**

Transporti i mbetjeve inerte do te behet me mjetet transporti kamione. Per vazhdime si do te percatitet dhe percaktohet vendi I parkimit te makinerive, kryesisht ne siperfaqen e percatitur me pare dhe nuk do te demtohen siperfaqe te tjera vetem per parkim.

Masat teknike ne terren per mbrojtjen e tokes jane :

1. Pikitimi dhe hapja e kanaleve te drenazhimit ne siperfaqe.
2. Pergjate segmenteve rrugore do te happen kanale anesore qe do te ndalin forcen gerryese te ujrale te rreshjeve, ndersa per gjate sheshit te depozitimit te inerteve do te happen kanale periferike kufizuese per te frenuar gerryerjen dhe transportin e tokes sipas gradientit te pjeses siperfaqesore.
3. Makinerite do te kontrollohen per gjendjen e tyre teknike dhe nese konstatohen pjeset edemtuara do te nderohen me njehere.

Kanalet e drenazhimit per gjate objektit do te mirembahen dhe pastrohen rregullisht si domos ne stinet me rreshje.

Kontrolli i erozionit siperfaqesor do te jetë nder masat me te rendesishme te mbrojtjes se mjedisit nga aktiviteti i kryer. Masat per kontrollin e erozionit jo vetem qe mbrojne siperfaqen e tokes nga demtimi por indirekt kontribon ne mbrojtjen e burimeve ujore dhe bimesise se zones.

### **Masat per mbrojtjen e ajrit.**

Ne veprimtarine e terheqjes ,transportit dhe depozitimit te mbetjeve inerte ,jane mjetet e transportit si burimi kryesor i ndotjes se ajrit. Per te parandaluar ndotjen e ajrit , automjetet do te koalidohen periodikisht dhe do te kontrollohen. Perdorimim i naftes me permbajtje te ulet squfuri ndikon ndjeshem ne ndotjen e ajrit.

Njekohesisht mjetet e transportit dhe makinerite e tjera do te jene burim i zhurmave, por duke u nisur nga lloji i aktivitetit te kryer,ato jane brenda limiteve te vendosura nga shtetet e BE.

## **Masat per mbrojtjen e biodiversitetit.**

Masat qe duhet te merren per mbrojtjen e botes se gjalle lidhen me mos demtimin pa aresye te drureve dhe bimesise se zones

### **Administrimi i mbetjeve urbane.**

Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i kryer si dhe ai jetesor i punetoreve do te grumbullohen e veçohen dhe me vone do te transportohen drejt vend grumbullimit te mbetjeve urbane .

### **Ndikimet e mundsheme ne mjedisin nderkufitar ( nese projekti ka natyre te tille).**

Projektet qe do te ndertohen jan parashikuar 7 kate ( 5 kate Banim + 2 kat Sherbime), 6 kate ( 4 kate Banim + 2 kat Sherbime), 4 kate ( 2 kate Banim + 2 kat Sherbime), 3 kate ,nuk kan karakter nderkufitar. Keto projekte do te shtrihet vetem ne siperfaqen e kufizuar nga kordinatat qe jane dhene ne tabelen e kordinatave, duke mos kaluar pertej ketyre kordinatave.

### **3. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Ne kuadrin e zbatimit te ketij projekti , veprimtarite qe do te jadin ndikime te mundeshme negative ne mjedis gjate fazave te ketij procesi dhe venies ne funksion te objektit do te zbuten me masat konkrete qe jane parashikuar ne kete raport.

- Ndiqimet negative ne biodiversitet gjate fazes se ndertimit rezultojne ne nje mase te paperfillshme, nuk ka ndikime potenciale ne flore dhe faunen ne perjithesi.
- Nuk jane parashikuar ndikime te rendesishme ne ujrat nentokesore gjate fazes se ndertimit
- Aktivitetet e projektit duke marre ne konsiderate parametrat gjeologjike dhe kategorine e tokes , si rreshqitje, erozionin etj. Vleresohen me probabilitet te ulet dhe me ndikime te paperfilleshme .
- Ndiqimet nga zhurmat dhe dridhjet gjate ndertimit jane te perk oheshme , te lokalizuara dhe do te zbuten me menaxhim te mire gjate zbatimit te projektit.
- Nuk do kete ndikim te paparashikuar te permbytjeve gjate operimit
- Nuk ka ndikim negative potencial nga zhurmat ne banoret perreth dhe ky eshte I pa perfillshem .

**Ne perfundim mund te themi se implementimi I projektit ne studim do te kete ndikim te drejtperdrejte ne mjedisin e zones , por ky ndikim do te jetë vetem gjate fazes se ndertimit dhe nuk do akumulohet ne mjedis perreth.**

**Ndiqimi ne mjedis nga realizimi I ketij projekti do te jetë I perkoheshem dhe ne nivele te uleta dhe pas perfundimit te projektit do te kemi nje peisazh me te rregullt dhe me te paster.**

**Ivestitori do te jetë I gatshem te bashkpunoje me institucionet perjegjese per mbrojtjen e mjedisit ne kuader te ruajtjes se cilesise mjedisore ne zone.**

**Pergatiti Raportin Paraprak te VNM**

**Ing: Blerina Mazari**

